**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

KOMISIONI RREGULLATOR

**Data:** 20 Prill 2021 | **Nr: 20**

# VENDIM

## PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË PUNËS TË KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE DHE GRUPIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021

Në mbështetje të nenit nenin 20, pika 1, shkronja ”gj”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë “Udhëzuesin e punës për Komisionin e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve dhe Grupin e Numërimit të Votave”, në ndihmë të anëtarëve të KZAZ-ve dhe GN-ve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas materialit bashkëlidhur.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

| | |
|---|---|
| **Ilirjana NANO** | **Kryetare** |
| **Arens ÇELA** | **Anëtar** |
| **Dritan ÇAKA** | **Anëtar** |
| **Helga VUKAJ** | **Anëtar** |
| **Muharrem ÇAKAJ** | **Anëtar** |

# UDHËZUES I PUNËS PËR KZAZ DHE GNV

## ZGJEDHJET PËR KUVEND
## 25 PRILL 2021



## Përmbajtja e lëndës

**Përmbajtja e lëndës** ........ 1
**Rregulla të etikës** ........ 2
**Shkurtime** ........ 3

**I. GRUPET E NUMËRIMI TË VOTAVE DHE VENDE TE NUMËRIMIT TË VOTAVE** ........ 5
1. **Detyrat administratës zgjedhore në VNV** ........ 5
2. **Ngritja dhe përbërja e GNV** ........ 5
3. Organizimi VNV-së dhe Planvendosja e saj ........ 7
4. Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave ........ 8
Planvendosja e VNV-së ........ 9
4. Vëzhguesit ........ 10
4.1 Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve ........ 10
4.2 Vëzhguesit në VNV ........ 10
5. Personat e pranishëm, rregulli dhe qetësia në VNV ........ 10
6. Materialet dhe dokumentacioni zgjedhor bazë për GNV-të ........ 11
**II. MARRJA NË DORËZIM E MATERIALEVE ZGJEDHORE** ........ 12
1. Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja ........ 12
2. Detyrat e grupit të marrjes në dorëzim ........ 12
3. Marrja në dorëzim të materialeve zgjedhore të sjella nga KZAZ-ja ........ 13
4. Konstatimi dhe Deklarimi i Kutive të Parregullta gjatë dorëzimit ........ 15
5. Sistemimi i kutive të votimit dhe materialeve të votimit në VNV ........ 16
**III. PROCESI I NUMËRIMIT** ........ 16
1. Veprimet paraprake të KZAZ-së ........ 16
2. Fillimi i procesit të numërimit ........ 17
3. Radha e numërimit ........ 18
4. Veprimet paraprake të GN-it ........ 18
5. Hapja e kutisë së votimit ........ 18
6. Numërimi i votave ........ 20
7. Vlerësimi i fletëve të votimit të vlefshme dhe të pavlefshme ........ 20
8. Vlerësimi i votave ........ 21
9. Kontestimi dhe Rivlerësimi i Votës ........ 23
10. Numërimi i votave për subjektet zgjedhore ........ 24
11. Hapja e kutive të materialeve të votimit ........ 26
11.1 Procesverbali për Mbylljen e Votimit gjendet në kutinë e materialeve të votimit ........ 27
**IV. TRANSMETIMI ELEKTRONIK DHE NXJERRJA E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE** ........ 29
1. Veprimet para plotësimit të Tabelës së Rezultateve të zgjedhjeve për QV për subjektet ........ 29
2. Plotësimi i tabelës së rezultateve paraprake të zgjedhjeve të subjekteve dhe kandidatëve ........ 31
3. Hedhja dhe transmetimi elektronik I të dhënave në tabelat e pasqyruara në tabelën e rezultateve të QV-së ........ 31
4. Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore/kandidatët e listave shumëemërore të partive politike dhe koalicioneve zgjedhore/nga KZAZ-ja ........ 32
5. Procedura e numërimit të votive për kandidatët e listave shumëemërore të partive politike dhe koalicioneve zgjedhore ........ 33

**V. PËRGJEGJËSITË DHE SANKSIONET** ........ 35
1. Rastet e përgjegjësisë administrative dhe penale ........ 36
2. Veprat penale ........ 36
**VI. PAS NXJERRJES SË REZULTATEVE - DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NË KQZ** ........ 37

**SHEMBUJ TË VLERËSIMIT TË VOTAVE** ........ 39

## RREGULLA TË ETIKËS

Për t'iu përmbajtur parimeve bazë të administrimit të zgjedhjeve, siç parashikohet në ligj, në mënyrë të veçantë kërkesave për legjitimitet, transparencë, paanshmëri, profesionalizëm dhe në mënyrë të pavarur, anëtarët e komisioneve zgjedhore, anëtarët e GNV, gjatë kryerjes së detyrës, duhet të dëshmojë sjellje etike:

- Të zbatojë me përpikmëri Kodin Zgjedhor, aktet e KQZ-së, dhe vendimet e KZAZ-së;
- Të paraqitet rregullisht në detyrë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-së, me përjashtim të rasteve, kur për arsye objektive dhe me njoftim paraprak të Kryetarit të KZAZ-së, nuk mund të jenë të pranishëm;
- Të deklarojë menjëherë rastet e marrëdhënies së krushqisë të afërt ose gjinisë deri në shkallë të katërt, apo të marrëdhënies së punës me ndonjërin nga kandidatët që konkurojnë në zonë;
- Të veprojë në mënyrë të paanshme për zbatimin e detyrave, vendimeve të KQZ dhe KZAZ-së;
- Të mos lejojë që interesat private të bien ndesh me detyrën, të shmangë konfliktin e interesit dhe të mos shfrytëzojë detyrën për interesin privat;
- Të respektojë normat e njohura dhe të gjithëpranuara të etikës në komunikim e sjellje;
- Të jetë i ndershëm në kryerjen e detyrave, i përkushtuar dhe korrekt, duke patur parasysh vetëm interesin publik;
- Tëi ofrojë cilësinë më të lartë të shërbimit të kërkuar, që zgjedhësit të ushtrojnë të drejtat e tyre në respektim të plotë të të drejtave dhe procedurave ligjore;
- Të trajtojë të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, kandidatët, partitë politike dhe votuesit, vëzhguesit, në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa i dhënë avantazh ndonjë partie politike apo grupi interesi;
- Të mos pranojë dhurata apo favore nga partitë politike, organizatat apo personat, të cilët mund ose jo të jenë të përfshirë në procesin zgjedhor;
- Të mos mbajë apo tregojë simbole, shenja dalluese, apo ngjyra partiake;
- Të mos shprehë pikëpamje mbi tema, të cilat mund të jenë çështje politike në zgjedhje;
- Të mos marrë pjesë në aktivitete të paautorizuara, përfshi edhe aktivitetet private, që mund të çojnë drejt një konflikti aktual apo të perceptuar interesi me detyrën e zyrtarit zgjedhor;
- Të deklarojë çdo marrëdhënie që mund të çojë në konflikt interesi me detyrat e tyre.
- Të jetë rigoroz në zbatimin e masave anticovid-19, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, garanton opinionin publik, se do të ushtrojë të gjithë autoritetin ligjor, që zyrtarët zgjedhorë, të angazhuar për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, të kryejnë detyrat me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm, për të garantuar standarde të larta dhe integritetin e këtij procesi, si shërbim dhe detyrim ndaj zgjedhësve, subjekteve zgjedhore, vëzhguesve vendas dhe të huaj.

Udhëzuesi i punës së KZAZ-së dhe Grupit të Numërimit të Votave [GNV] është konceptuar për t'u ardhur në ndihmë anëtarëve të GNV-ve dhe KZAZ-së në zbatimin korrekt të procedurave që ndiqen në Vendin e Numërimit të Votave.

Ky Udhëzues shpjegon të gjitha hapat kyç që duhen ndjekur në fazat e procesit të numërimit të votave, duke filluar nga rregullimi i vendit të numërimit të votave, teknologjia mbështetëse e numërimit të votave, të drejtat e detyrat e vëzhguesve, marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore nga grupet e marrjes në dorëzim, procesi i numërimit të votave, vlerësimi i fletëve të votimit (vota të vlefshme, të pavlefshme, të kontestuara), numërimi i votave për subjektet dhe kandidatët e tyre të listave shumemërore deri në nxjerrjen dhe transmetimin e rezultateve ZAZ-së, si dhe dhe përgjegjësitë e sanksionet për anëtarët e GNV-ve dhe KZAZ-së.

Udhëzuesi, gjatë trajnimit do të shërbejë për:

- njohjen, kuptimin dhe përvetësimin e procedurave që duhen zbatuar në VNV;
- ngritjen e nivelit profesional e administrues të anëtarëve të GNV-ve dhe KZAZ-së;
- aftësimin e anëtarëve GNV-ve dhe të KZAZ-së në aspektin praktik, dhe do të ndikojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në VNV, duke kontribuar në:
- menaxhimin ligjor dhe eficent për këtë proces mjaft të rëndësishëm.
- mirëadministrimin e procesit zgjedhor dhe zbatimin ligjor të detyrave të tyre funksionale, në përputhje me parimet dhe rregullat e vendosura në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të nxjerra nga KQZ, të cilat rregullojnë procesin e numërimit të votave në VNV.

Puna e GNV-ve do të sigurojë që e drejta e zgjedhësit/votuesit e shprehur me vullnetin e tij lirisht në ditën e zgjedhjeve do të materializohet në numërimin korrekt të çdo vote.

Udhëzuesi mund të jetë gjithashtu i dobishëm për të gjithë personat e interesuar, të cilët marrin pjesë në procesin zgjedhor: vëzhguesit zgjedhorë, partitë politike, koalicionet, kandidatët dhe median, për të kuptuar më mirë rregullat dhe procesin e numërimit të votave në vendin e numërimit të votave.

***Komisioni Qendror i Zgjedhjeve***

## Shkurtimet e përdorura në Udhëzues:

| | |
|---|---|
| **KZ** | Kodi Zgjedhor i Shqipërisë; |
| **KP** | Kodi Penal i Shqipërisë; |
| **KQZ** | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; |
| **KZAZ** | Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor; |
| **KQV** | Komisioni i Qendrës së Votimit; |
| **VNV** | Vendi i Numërimit të Votave; |
| **GNV** | Grupi i Numërimit të Votave |
| **MODEL** | Model vendimi, tabele, procesverbali. |
| **TPR** | Tabela Përmbledhëse e Rezultateve |

## I. GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE

### 1-Detyrat administratës zgjedhore në VNV

**GNV**-të numërojnë votat për:

1. **Subjektet zgjedhore**:
- nxjerrin rezultatin e zgjedhjeve për çdo QV të zonës së administrimit zgjedhor (ZAZ) përkatës për **partitë politike**, **koalicionet**, **kandidatin e propozuar nga zgjedhësit**;
- duke plotësuar Tabelën e rezultateve për partitë politike, koalicionet, kandidatin e propozuar nga zgjedhësit për çdo QV, **Model KZAZ 29**

2. **Subjektet zgjedhore**:
- nxjerrin rezultatin e zgjedhjeve për çdo QV të ZAZ-së përkatëse, për **kandidatët për deputet** të **partive politike** ose **koalicionit zgjedhor**.
- duke plotësuar Tabelën e rezultateve për kandidatët për deputet për çdo parti politike ose koalicion zgjedhor për çdo QV, **Model KZAZ 30.**

**KZAZ :**

- ✓ Miraton Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ-në për subjektet zgjedhore **Model KZAZ 31.**
- ✓ Merr vendimin "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës së administrimit zgjedhor, **Model KZAZ-33.**
- ✓ Miraton Tabelën përmbledhëse e rezultateve për kandidatët për deputet për çdo parti politike ose koalicion zgjedhor, **Model KZAZ 32.**
- ✓ Merr vendimin "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës së administrimit zgjedhor, për kandidatët për deputet për çdo parti politike ose koalicion zgjedhor, **Model KZAZ-34**.

**!** Tabela përmbledhëse e Rezultatit për partitë politike, koalicionet, kandidatët/in e propozuar nga zgjedhësit, **Model KZAZ 31**, *për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja*, **jo më vonë se ora 22$^{00}$ e datës 26 PRILL 2021 (KZ, n.122/1).**

## 2.Ngritja dhe përbërja e GNV

Grupet e Numërimit të Votave:

- ✓ ngrihen 10 (dhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
- ✓ përbëhen nga 4 (katër) anëtarë, numëruesi parë, sekretari dhe dy anëtarë.

Numri i Grupeve të Numërimit të Votave, të cilat angazhohen në të njëjtën kohë për numërimin e votave në VNV nuk mund të jetë më pak se tre dhe me shumë se dhjetë.

KZAZ-ja cakton me vendim numrin e GNV-ve që do të numërojnë votat në rang ZAZ-je

GNV-të janë 2 për çdo tavolinë numërimi. (neni 94/2 i Kodit Zgjedhor)

Një grup numërimi numëron **jo më pak se 5** dhe **jo më shumë se 10 qendra votimi**.
Për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.04.2021, partitë politike që kanë të drejtën për të propozuar numëruesin e parë dhe sekretarin e GNV janë respektivisht Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, që kanë të drejtë të propozojnë kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-ve.

Çdo Grup Numërimi përbëhet nga numëruesi i parë, sekretari dhe 2 anëtarë.

Numëruesi i parë është /propozohet nga i:
Partisë Socialiste në KZAZ-të me numër tek, ku kryetari KZAZ-së është i PD, ndërsa
Partisë Demokratike në KZAZ-të me numër çift, ku kryetari KZAZ-së është i PS.

*Numëruesi i parë është i përkatësisë politike të kundërt me sekretarin e GNV.*

Për zgjedhjet e datës 25 prill 2021 anëtari i tretë i GNV-ve propozohet nga Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia politike e shumicës parlamentare. (Vendimi 193, datë 31 Mars 2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve)
Anëtari i katërt i GNV propozohet nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia politike e opozitës parlamentare.

**!** *Nëse nuk është e mundur të plotësohet numri i kërkuar, një GNV funksionon me jo më pak se dy anëtarë* (KZ, neni 95/3).

GNV numërtohen me numër rendor rritës dhe përfundojnë gjithnjë me numër çift

**Grupi i dytë** i **Numërimit të Votave** fillon menjëherë punën pasi
GNV-ja e parë përfundon punën e saj.
Grupet e dyta të Numërimit të Votave qëndrojnë në gadishmëri dhe me vendim të KZAZ-së zëvendësojnë menjëherë grupet e para edhe nëse grupet e para e ndërpresin punën pa shkaqe të përligjura.

Nëse nuk është e nevojshme, grupet e dyta të numërimit nuk futen në punë.

! KZAZ-ja i numërton GNV-të me numër rendor rritës. Numri i fundit rendor është gjithmonë numër çift.

3-**Organizimi i VNV-së dhe planvendosja e saj** (KZ, neni 94)



Menjëherë me marrjen në dorëzim nga KQZ-ja të VNV-së, KZAZ-ja në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore**,** merr masa për organizimin e VNV-së, sipas planvendosjes (**skema VNV**, **fq. 8**).

- **caktimin e një vendi të përshtatshëm ku do të afishohen gjatë procesit të numërimit**:
  - kopje të tabelës së rezultatit të qendrës së votimit, të vulosura nga Sekretari i KZAZ-së, me vulën e KZAZ-së;
  - kopje të tabelës Përmbledhëse të Rezultatit, të vulosura nga Sekretari i KZAZ-së, me vulën e KZAZ-së.

Të gjithë vëzhguesit e akredituar, përmes tabelave të afishuara në vend të dukshëm kanë mundësi të njihen më rezultatet gjatë procesit të numërimit.

**Policia organizon ruajtjen e ambientit të Vendit të Numërimit të Votave prej orës $18^{00}$ të ditës së zgjedhjeve deri në momentin e nxjerrjes së tabelës së rezultatit nga KZAZ-ja.**
**Punonjësi i Policisë së Shtetit qendron jashtë ambienteve të Vendit të Numërimit të Votave, sipas caktimit të bërë nga KZAZ-ja** .

Zëvëndësimi i anëtarëve të GNV-së kryhet vetëm nga partite politike qe kane të drejtën në bazë të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Anëtari zëvendësues i GNV-ve, caktohet nga KZAZ-ja, në bazë të shortit të hedhur
a. Sekretari i KZAZ-së përzgjedh të gjithë anëtarët e KQV-ve të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 19/ 2021 të Komisionit Rregullator në KQZ;
b. Anëtarët e KQV-ve renditen, në mënyrë rastësore, në lista sipas partive politike të cilat i kanë propozuar
c. Çdo emri, të renditur në secilën listë, i vendoset nga një numër rendor rritës, duke filluar nga 01.
d. Në një enë transparente, vendosen shirita letre ku janë shënuar numrat rendorë që i korrespondojnë çdo anëtari të KQV-së të partisë politike përkatëse të renditur në listë.
e. Kryetari i KZAZ-së tërheq shirita letre në numër të barabartë me numrin e anëtarëve të GNV-ve që mungojnë.
f. Anëtari i KQV-së, i emëruar me propozim të partisë politike, për të cilën hidhet shorti, të cilit i korespondon numri rendor i shënuar në shiritin e letrës së tërhequr, caktohet anëtar i Grupit të Numërimit.

Plotësimi i vakancës

Kur vendi i një anëtari të Grupit të Numërimit mbetet vakant gjatë procesit të numërimit të votave, partia politike e cila kishte propozuar anëtarin, paraqet menjëherë propozimin e ri.
Nëse partia politike përkatëse nuk paraqet propozimin për plotësimin e vendit të mbetur vakant, GNV vazhdon numërimin kur anëtarët në detyrë nuk janë më pak se dy.
Nëse nga vakancat e krijuara GNV-ja mbetet me më pak se dy anëtarë, për plotësimin e vakancave KZAZ-ja zbaton procedurat e shortit të përcaktuara në rastin e zëvëndësimit të anëtarëve sipas nenit 10 të vendimit nr.19, datë 14.04.2021, të Komisionit Rregullator.

## 4 -Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave



Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave – **videokamera dhe monitorë** – instalohet në VNV. Çdo tavolinë numërimi është e pajisur me një kamera dhe monitor. KZAZ-ja kujdeset për ruajtjen nga dëmtimet e jashtme të kësaj teknologjie nga momenti i fillimit të procesit të numërimit të votave në VNV dhe deri në nxjerrjen e rezultatit të Zonës së Administrimit Zgjedhor.

Grupi i numërimit të votave është përgjegjës për ekspozimin e çdo flete votimi në kamera.

*-Regjistrimi filmik i procesit ruhet në mënyrë elektronike dhe dorëzohet në KQZ së bashku me materialet e tjera zgjedhore. Ju mund t'i referoheni n.94, p.4 e KZ. Ky regjistrim bëhet vetëm për numërimin e votave të subjekteve zgjedhore.*

**Kujdes!** KZAZ-ja organizon hapësirën e VNV-së duke siguruar që:
**Hapësirat ku kryhet numërimi i votave** të jenë **të mjaftueshme** dhe **të ndara qartë** nga **hapësirat** për **vëzhguesit**, **kandidatët** dhe **mediat**.
**Vendqëndrimi i caktuar për vëzhguesit të jetë në distancë 1.5 m nga monitori**.

**Skema e VNV**



## 5 - VËZHGUESIT

### 5 1-Të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve (KZ, neni 7)



Vëzhguesit në VNV kanë **këto të drejta**:

- Të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e procesit zgjedhor në VNV;
- Të njoftojë KZAZ-në [njoftimi bëhet me ngritjen e dorës] **në rast** të konstatimit të pasaktësive ose parregullsive;
  - gjatë procesit të numërimit të votave dhe
  - gjatë verifikimit të materialeve të votimit, që gjenden në Kutinë e Materialeve të Votimit;
- Të kundërshtojë vlerësimin e votës së bërë nga numëruesi i parë, por jo gjatë rivlerësimit;
- Të marrin kopje të
  - Tabelave të rezultateve të qendrave të votimit;
  - Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve për subjektet zgjedhore dhe kandidatëve për deputetë të listave të tyre shumemërore të ZAZ-së dhe
  - Procesverbaleve të konstatimit.
  - Procesverbalin per votat e vlefshme per partitë politike dhe koalicionet ku nuk ka votim parapelqyes per kandidatet;
  - Procesverbalin përmbledhës per votat e vlefshme per partitë politike dhe koalicionet ku nuk ka votim parapelqyes per kandidatet;
- Të paraqesin vërejtje me shkrim para KZAZ-së për çdo lloj parregullsie që vërejnë.

Vëzhguesit kanë **këto detyra:**

- të respektojnë kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe vendimet dhe urdhërimet e KZAZ-së, ku janë akredituar;
- nuk duhet të kenë kontakt fizik me materialet e votimit.
- të paraqiten para komisioneve të zgjedhjeve me autorizimin e lëshuar nga KQZ-ja ose KZAZ-ja, të shoqëruar me dokument identifikimi [pasaportë ose letërnjoftimi/kartë identiteti];
- të mos ndërhyjnë në procesin zgjedhor dhe të mos pengojnë, procesin e numërimit të votave, shpalljen e rezultateve dhe aktivitetin e komisioneve zgjedhore [KZAZ-së, GNV-ve];
- të respektojnë rregullat e etikës në marrëdhëniet me komisionerët zgjedhorë dhe vëzhguesit e tjerë.
- të mos komentojnë dhe/ose të debatojnë vendimet e KZAZ-së dhe GNV-së.

**Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore të akredituar në VNV gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave nga Grupet e Numërimit janë të detyruar të qendrojnë në vendin e caktuar për ta nga KZAZ-ja**.

TË GJITHË PERSONAT E PRANISHËM DUHET TË MBAJNË DOKUMENT IDENTIFIKUES
SIPAS MODELIT TË MIRATUAR NGA KQZ.

### 5. 2 -Vëzhguesit në VNV

Vëzhguesi i KZAZ-së mund të jetë vëzhgues dhe në VNV

| Çdo tavolinë numërimi | | |
|---|---|---|
| **1 vëzhgues** | 2 vëzhgues | 3 vëzhgues |
| - Partisë politike, e cila është renditur në fletën e votimit;<br><br>- Kandidatit të paraqitur nga një grup zgjedhësish;<br><br>- Një OJF-je (organizatë jo-fitimprurëse) shqiptare. | - Një OJF-je (organizatë jo-fitimprurëse) e huaj,<br><br>- Organizatave ndërkombëtare<br><br>• *Vëzhguesit e huaj mund të shoqërohen nga një përkthyes brenda ambienteve të VNV-së.*<br><br>*Përkthyesi është i pajisur me autorizimin përkatës lëshuar nga KQZ-ja.* | *Çdo koalicion* |

***Kujdes!*** *Për partitë politike që paraqiten në zgjedhje si koalicion, të drejtën për të caktuar vëzhgues e ka vetëm partia udhëheqëse.*

### 6 -Personat e pranishëm, rregulli dhe qetësia në Vendin e Numërimit të Votave

(KZ, neni 121)

Në VNV duhet të qëndrojnë vetëm:

- Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së;
- Anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave të caktuar me vendim të KZAZ-së, të cilët futen në punë;
- Kandidatët;
- Vëzhguesit akredituar;
- Përfaqësuesit e akredituar të medias;
- Operatorët e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave;
- Personeli teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave;
- Stafi i KQZ-së i pajisur me autorizim të posaçëm nga KQZ-ja.

**KUJDES! KZAZ:**

- **merr masa** dhe **është përgjegjëse** për **moslejimin e personave të paautorizuar dhe të paakredituar** nga KQZ ose KZAZ [ KZ n.121/ p.1];
- përgatit listën me emrat e personave që lejohen të hyjnë në VNV, e cila vuloset me vulëne KZAZ-së;
- cakton **dy** anëtarë të saj, të cilët pajisen me këtë listë dhe lejojnë të hyjnë në VNV çdo person që:
- **është i pajisur me autorizim/akreditim të lëshuar nga KQZ-ja ose KZAZ-ja dhe dokument identifikimi të vlefshëm [letërnjoftimi/kartë identiteti ose pasaportë].**
- **Përfaqësuesit e medias të akredituar nga KQZ kanë të drejtë të jenë të pranishëm si media në cdo VNV/KZAZ.**
- i përputhen të dhënat e dokumentit të identifikimit/autorizimit/akreditimit të lëshuar nga KQZ-ja ose KZAZ-ja me emrin, mbiemrin që gjendet në listë.

## 7 -Materialet zgjedhore dhe dokumentacioni i punës për GNV-të

**A. Dokumentacioni i punës:**

- Kodi Zgjedhor;
- Udhëzues;

Materialet që i dërgohen KZAZ-së për GNV-të përcaktohen sipas një inventari, të ndara, si vijon:

| MODELI | Përmbajtja e Procesverbalit |
|---|---|
| **Model GNV 1** | Procesverbal për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara. |
| **Model GNV 2** | Procesverbal për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit të QV-së nr._____ |
| **Model KZAZ-29** | Tabelë e rezultateve për partitë politike, koalicionet, kandidatin e propozuar nga zgjedhësit në QV-në |
| **Model KZAZ-29/1** | Procesverbalin per votat e vlefshme per partitë politike dhe koalicionet ku nuk ka votim parapelqyes per kandidatet; |
| **Model KZAZ-31/1** | Procesverbalin përmbledhës per votat e vlefshme per partitë politike dhe koalicionet ku nuk ka votim parapelqyes per kandidatet |
| **Model KZAZ-30** | Tabelë e rezultateve për kandidatët për deputet të listave shumemërore |

**B. Set i kancelarive:**

- Shenjë dalluese për GN;
- Pincë për këputjen e kodeve të sigurisë;
- Dokument identifikimi;
- Vula me kode sigurie metalike;
- Makinë llogaritëse;
- Stilolaps;
- Letër, format A4;
- Etiketa adezive për QV që numërohen



<table>
<tr><td rowspan="6">Zarfat e emërtuar</td><td>Sipas kutisë së votimit me fletët e votimit që numërohen për:</td></tr>
<tr><td>Subjektin zgjedhor</td></tr>
<tr><td>Zarfi i fletëve të votimit të vlefshme në të cilat është votuar qartësisht vetëm për subjektin zgjedhor Z.06 (për çdo subjekt zgjedhor, parti politike, kandidat i propozuar nga zgjedhësit)</td></tr>
<tr><td>Zarfi i fletëve të votimit të kontestuara, Z.04</td></tr>
<tr><td>Zarfi i fletëve të votimit të pavlefshme, Z.05</td></tr>
<tr><td>Zarfi i të gjitha fletëve të votimit të vlefshme për subjektin zgjedhor Z.08</td></tr>
</table>

## II. MARRJA NË DORËZIM E MATERIALEVE ZGJEDHORE

### 1-Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja

**KZAZ**-ja, pas mbylljes së procesit të votimit, ngre dhe organizon në VNV një ose më shumë **grupe të marrjes në dorëzim** të materialeve të votimit të sjella nga KQV-të.
Grupet e marrjes në dorëzim përbëhen nga 2 anëtarë të KZAZ-së të përkatësive të kundërta politike.

**Nëse është e nevojshme, KZAZ** cakton **dy persona** në ndihmë **për çdo grup të marrjes në dorëzim**, nga lista e anëtarëve të GNV-ve, të cilët merren kryesisht me sistemimin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së të përkatësive të kundërta politike.

Grupet e Marrjes në Dorëzim të KZAZ-së përkatëse, marrin në dorëzim nga Kryetari, dhe Sekretari i çdo KQV-je, sipas procesverbalit, **Model KZAZ 24,** në të cilën është firmosur edhe nga punonjësi i policisë që ka shoqëruar kutitë e votimit dhe materialeve zgjedhore:
**a.** Kutinë e votimit me fletët e votimit;
**b.** Kutinë me materialet e votimit.

! Pajisjet e teknologjisë (PEI dhe Kamera) merren në dorëzim për t'jua dhënë menjëherë punonjësve të KQZ-së të autorizuar për tërheqjen e tyre. KZAZ ndjek procedurat specifike sipas udhëzimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

### 2- Detyrat e grupit të marrjes në dorëzim

Grupi i marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore**:**

- funksionon vetëm për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore të sjella nga KQV-të në VNV.
- merr në dorëzim kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutinë me materialet e votimit të çdo QV-je, sapo ato mbërrijnë në VNV.

**Kujdes!**
Grupet e marrjes në dorëzim, **në asnjë rast nuk mund të refuzojnë marrjen në dorëzim të kutive të votimit**, **kutisë së materialeve të votimit** apo **materialeve të tjera** të logjistikës **zgjedhore**, të cilat vijnë në VNV nga KQV-të, në juridiksionin e KZAZ-së përkatëse. Ju mund t'i referoheni nenit 5, pika 3, të vendimit 14 datë 10.04.2021 të Komisionit Rregullator.

**Kutitë me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit duhet të merren në dorëzim sapo të mbërrijnë në VNV.**

**Gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore**, grupet e marrjes në dorëzim të KZAZ-së **plotësojnë** Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim**, Model PV-KZAZ-24.**

### 3- Marrja në dorëzim të materialeve zgjedhore të sjella nga KQV-ja në VNV

Gjatë procesit të marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore, grupi i marrjes në dorëzim ndjek këtë procedure:



- Merr nga sekretari i KZAZ-së, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV, e cila përmban:
  - Procesverbalin **Model KZAZ 23;**
  - **Modelin krahasues të vulës [specimenin]** së kryetarit të KQV-së;
  - Procesverbalin **Model  KZAZ 22**.
    - Shënon në Procesverbalin **Model KZAZ 24** numrat e kodeve të sigurisë të vulave me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit.

**Kujdes** në plotësimin e **Procesverbalit Model KZAZ 24**, pasi çdo rubrikë e këtij procesverbali shërben për procedurat e sqaruara në faqen 14.

Grupi i marrjes në dorëzim|:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

| KZAZ nr. | 3 |
|---|---|
| KQV nr: | 0235 |

| PROCESVERBAL<br>Për pajisjen e KQV nga KZAZ me vula me kode të sigurisë | |
|---|---|
| Datë: | 24.04.2021 |

1.Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr_____, në bazë të nenit 100, paragrafit 1, shkronja "d", dhe 4, të ligjit 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, i dorëzon vula me kode të sigurisë KQV-së nr. __________.

| Nr | Kodi i vulës së sigurisë | Nr | Kodi i vulës së sigurisë rezervë |
|---|---|---|---|
| 1 | 20 6080 | 10 | 21 98 70 |
| 2 | 20 6081 | 11 | 21 98 71 |
| 3 | 20 60 82 | 12 | 21 98 72 |
| 4 | 20 6083 | | |
| 5 | 20 60 84 | | |
| 6 | 20 60 85 | | |
| 7 | 20 60 86 | | |
| 8 | 20 60 87 | | |
| 9 | 20 60 88 | | |

2.Ky procesverbal mbahet në 3 (tre) kopje. Një nga kopjet e procesverbalit dorëzohet nga KZAZ në KQZ.

Dorëzuesi nga: KZAZ 3 — Marrësi në dorëzim nga KQV nr. 0235

Kryetar: ________ (emër mbiemër firmë) — Kryetar: ________ (emër mbiemër firmë)

Zv/Kryetar: ________ (emër mbiemër firmë) — Sekretar: ________ (emër mbiemër firmë)

Sekretar: ________ (emër mbiemër firmë)

VULA

Miratuar me Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr 37, datë 17.12.2020

Model KZAZ 23

- Verifikon në çast nëse:
- ❖ përputhen numrat e kodeve të vulave të sigurisë me të cilat janë mbyllur kutia e votimit me fletët e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, me numrat e kodeve të vulave të sigurisë të shënuara në Procesverbalin e dorëzimit te vulave me kode të sigurie, për pajisjen e KQV-së nga KZAZ, **Model KZAZ 23**;
- ❖ vendosja e vulave me kode sigurie është bërë në mënyrë të tillë, që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;
- ❖ mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie;
- ❖ kutia, trupi apo kapaku i saj:
  - **a.** ka thyerje ose çarje, që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialit tjetër të votimit.
  - **b.** është e llojit, formës ose përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara me vendimin e KQZ-së.

Pasi kanë përfunduar procesin e verifikimit të Kutive të votimit me fletët e votimit dhe Kutisë së Materialeve të Votimit, anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim veprojnë si më poshtë:

• Shënojnë në Procesverbalin Model **KZAZ 24**:

- Numrin e KZAZ-së, numrin e KQV-së, Qarkun, datën [në krye të këtij procesverbali].
- Numrat e kodeve të vulave të sigurisë, me të cilat është mbyllur kutia e votimi me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit, duke i krahasuar me **ModelKZAZ 23**;
- Kohën e marrjes në dorëzim, datën dhe orën.

Pas dorëzimit të materialeve të votimit në KZAZ, anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim, kryetari i KQV-së, sekretari i KQV-së nënshkruajnë Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim **Model KZAZ 24.**


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

| | |
|---|---|
| KZAZ nr. | 3 |
| KQV nr. | 0235 |
| Qarku | SHKODËR |

PROCESVERBAL
Për dorëzimin nga KQV në KZAZ të materialeve të votimit
Datë: 25.04.2021 Ora: 21:00

Ky procesverbal mbahet ne 4 (katër) kopje. KZAZ është e detyruar që të dorëzojë faqen e parë origjinale në KQZ. Kopjen e 2-të e mban KZAZ-ja, kopja e 3-të i jepet KQV-së dhe një kopje e merr punonjësi i Policisë së Shtetit.

1.Komisioni i Qendrës së Votimit, në zbatim të nenit 115, paragrafët 2,3,4,7 dhe 8, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë", të ndryshuar, dorëzon:

1 Kuti Votimi me nr. të vulave të sigurisë: *kutia e votimit duhet të jetë e vulosur me 5 vula (kode)*

1.1 Kjo kuti votimi është: a. e rregullt ☒ b. e parregullt ☐

1.2. Nëse kutia e votimit është e parregullt, shëno parregullësitë e konstatuara:

KUTIA E VOTIMIT ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, KODET E TË CILAVE JANË:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1) 206080 | 2) 206081 | 3) 206082 | 4) 206083 | 5) 206084 |

2 Kuti e Materialeve Zgjedhore me nr. të vulave të sigurisë: (*duhet të jetë e vulosur me 4 vula/kode*)

2.1 kutia e materialeve zgjedhore është: a. e rregullt ☒ b. e parregullt ☐

2.2. Nëse kutia e MZ është e parregullt, shëno parregullësitë e konstatuara:

KUTIA E MATERIALEVE ZGJEDHORE ËSHTË MBYLLUR ME VULAT, KODET E TË CILAVE JANË:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1) 206085 | 2) 206086 | 3) 206087 | 4) 206088 | 5) |

3 VULA REZERVË TË PAPËRDORURA:

| | | |
|---|---|---|
| 1) 219870 | 2) 219871 | 3) 219872 |

Punonjësi i Policisë së Shtetit: (emër, mbiemër, firmë)

Dorëzuesi nga: KQV nr. ______
Kryetar: (emër, mbiemër, firmë)
Sekretar: (emër, mbiemër, firmë)

Marrësi në dorëzim nga Anëtarët e grupit të marjes në dorëzim:
Anëtar: DESJANA SELIMAJ (emër, mbiemër, firmë)
Anëtar: Fisheld Ceka (emër, mbiemër, firmë)

Miratuar me Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.37, datë 17.12.2020

Model KZAZ 24

Punonjësi i Policisë firmos në procesverbal vetëm për shoqërimin, garantimin dhe mosprekjen e kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutisë së materialeve të votimit nga QV në VNV (pas firmosjes nga KZAZ-ja dhe KQV-ja).

- ✓ **Një kopje** të Procesverbalit të marrjes në dorëzim **Model KZAZ 24** e mban KZAZ-ja:
- ✓ **Një kopje** të **Model KZAZ 24** i jepet **KQV-së**, sekretarit të saj;
- ✓ Një kopje e merr punonjësi i **Policisë së Shteti, shoqërues**, i cili e dorëzon së bashku me raportin e shërbimit në komandën e strukturës, ku ai bën pjesë;

**Origjinali i Procesverbalit** të marrjes në dorëzim, **Model KZAZ-24, faqja e parë, administrohet nga KZAZ-ja, e cila është e deyruar që ta dorëzojë atë në KQZ**, sapo dorëzon materialet zgjedhore, së bashku me dokumentacionin zgjedhor.

**Kujdes!**

Me marrjen në dorëzim nga KQV-të të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutive me materialet e votimit, KZAZ-ja, sekretari i KZAZ-së, porosit operatorin të njoftojë në rrugë elektronike KQZ-në për:

- rregullsinë e tyre dhe
- kutitë e parregullta, nëse ka.

Sekretari i KZAZ-së i jep të dhënat operatorit që t'i hedh në formën përkatëse në kompjuter.

## 4-Konstatimi dhe Deklarimi i Kutive të Parregullta gjatë dorëzimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

| | |
|---|---|
| KZAZ nr. | 3 |
| KQV nr: | 0235 |

| PROCESVERBAL Për pajisjen e KQV nga KZAZ me vula me kode të sigurisë | |
|---|---|
| Datë: | 24.04.2021 |

1.Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr_____, në bazë të nenit 100, paragrafët 1, shkronja "d", dhe 4, të ligjit 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, i dorëzon vula me kode të sigurisë KQV-së nr. __________.

| Nr | Kodi i vulës së sigurisë | Nr | Kodi i vulës së sigurisë rezervë |
|---|---|---|---|
| 1 | 20 60 80 | 10 | 21 98 70 |
| 2 | 20 60 81 | 11 | 21 98 71 |
| 3 | 20 60 82 | 12 | 21 98 72 |
| 4 | 20 60 83 | | |
| 5 | 20 60 84 | | |
| 6 | 20 60 85 | | |
| 7 | 20 60 86 | | |
| 8 | 20 60 87 | | |
| 9 | 20 60 88 | | |

2.Ky procesverbal mbahet në 3 (tre) kopje. Një nga kopjet e procesverbalit dorëzohet nga KZAZ në KQZ.

Dorëzuesi nga: KZAZ 3 — Marrësi në dorëzim nga KQV nr. 0235

Kryetar: (emër mbiemër firmë) — Kryetar: (emër mbiemër firmë)

Zv/Kryetar: (emër mbiemër firmë) — Sekretar: (emër mbiemër firmë)

Sekretar: (emër mbiemër firmë)

VULA

Miratuar me Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.37, datë 17.12.2020 — Model KZAZ 23

Grupi i marrjes në dorëzim, njofton menjëherë KZAZ-në, **në rast se** gjatë procesit të marrjes në dorëzim të kutive me fletët e votimit **dhe** kutisë së materialeve të votimit, **konstatohet** një apo më shumë **parregullsi,** si:

- mospërputhjeje të numrave të kodeve të sigurisë të vulave me Procesverbalin **Model KZAZ 23;**
- hapësirë midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;
- një ose më shumë vula me kode sigurie mungojnë ose janë këputur;
- kutia, në trupin apo në kapakun e saj ka:
    - thyerje ose çarje, që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialit tjetër të votimit.
- kutia është e llojit, formës ose përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara me vendimin e KQZ-së.

Ky grup, për parregullsinë/të e konstatuar/a i kërkon KZAZ-së, që kutia përkatëse të shënohet "KUTI E PARREGULLT".




Anëtarët e KZAZ-së:

- paraqiten tek vendi i dorëzimit të kutive/së përkatëse të votimit me fletët e votimit dhe kutive/së të materialeve të votimit.
- verifikojnë parregullsinë e konstatuar,
- marrin vendim, kur e vlerësojnë kutinë e parregullt
- i vendosin etiketën "KUTI E PARREGULLT" dhe
- e vendosin në këndin e kutive të parregullta.

**Kujdes!**
Mospërputhjet (të gjitha) e konstatuara shënohen nga
- grupi i marrjes në dorëzim në Procesverbalin përkatës të Marrjes në Dorëzim, **Model KZAZ 24** dhe

- KZAZ-ja në **Librin e Protokollit të Mbledhjeve** dhe **Procesverbalin e Konstatimit.**

KZAZ-ja, kur konstaton parregullsitë si më sipër, vlerëson kutinë të parregullt, dhe i vendos etiketën "KUTI E PARREGULLT". KZAZ porosit menjëherë operatorin ta hedhë këtë fakt në sistemin elektronik.

**KUJDES!**
Në rast se:
**Kutia e votimit me fletët e votimit** është vlerësuar "KUTI E PARREGULLT", atëherë kutia me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit vendosen në këndin e kutive të parregullta.

**! Kutia e votimit me fletët e votimit, e përcaktuar si "KUTI E PARREGULLT", në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapet nga KZAZ-ja dhe nuk i kalojnë GNV-ve për vlerësim.**

Kjo kuti, dërgohet në KQZ, së bashku me kutinë e materialeve të votimit për nevoja të hetimit administrativ.

Kutia me fletët e votimit, e marrë në dorëzim e rregullt, dhe kutia e materialeve të votimit e vlerësuar nga KZAZ-ja “KUTI E PARREGULLT”, i nënshtrohet procedurave të hapjes dhe vlerësimit, së bashku me kutinë e votimit me fletët e votimit.
**Në çdo rast**, **parregullsitë** që kanë çuar në vlerësimin e kësaj kutie si “KUTI E PARREGULLT”, **shënohen** në **Librin e Protokollit të Mbledhjeve** dhe në **Procesverbalin e Konstatimit**.

### 5-Sistemimi i kutive të votimit dhe materialeve të votimit në VNV

**KZAZ**-ja mbikqyr, **drejton** dhe **kontrollon** procesin e marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit nga KQV-ja në KZAZ.

KZAZ-ja, ka **caktuar paraprakisht**
- **vendin** ku do të vendosen **kutitë e votimit** me fletët e votimit dhe **kutitë me materialet e votimit,** para dhe pas numërimit, sipas Planvendosjes Orientuese, si dhe
- **një hapësirë** për kutitë e votimit të vlerësuara “KUTI E PARREGULLT”.

Sapo kutia e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit, merren në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, **ato vendosen në vendin e caktuar**. Kjo hapësirë është brenda të njëjtit mjedis ku kryhet numërimi i votave.

! Mjedisi duhet të jetë i garantuar nga cdo ndërhyrje e personave të paautorizuar, nën mbikëqyrjen e KZAZ-së.

Kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit renditen sipas numrit të qendrës së votimit.

Qendrat e votimit renditen sipas rendit rritës të tyre.
E para në rradhë sipas renditjes së mësipërme, duhet të jetë QV-ja me numër rendor më të vogël dhe e fundit QV-ja më numër rendor më të madh.

QV-të bija vendosen menjëherë pas QV-së së origjinës.
- Në rreshtin e parë, rendit në rend rritës kutinë e votimit me fletët e votimit;
- Në reshtin e dytë rendit kutinë me materialet e votimit.

Në këtë renditje vendosen kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia e materialeve të votimit të çdo QV-je përbri njera tjetrës.

## III. PROCESI I NUMËRIMIT

### 1-Veprimet paraprake të KZAZ-së

**KZAZ**-ja pasi ka marrë në dorëzim bazën materiale të të gjitha QV-ve në juridiksionin e saj dhe pasi:
- është siguruar që anëtarët e GNV-ve, kanë marrë trajnimin e nevojshëm;
- sigurohet që VNV-ja është gati për fillimin e procesit të numërimit të votave;
- sigurohet që anëtarët e GN-it:
    - ✓ janë prezent në VNV dhe janë të ulur në tavolinat, përkatëse;
    - ✓ janë të pajisur me materialet e nevojshme logjistike;

- verifikon që personat e pranishëm në VNV janë vetëm personat e autorizuar nga KQZ-ja apo/dhe akredituar nga KQZ-ja ose KZAZ-ja.
- merr konfirmim nga operatori teknik për funksionimin normal të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

**Kujdes!** Ka transmetuar informacionin për:
- Qendrat e votimit në të cilat zgjedhjet nuk janë zhvilluar, në se ka;
- Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit të cilat janë vlerësuar "KUTI TË PARREGULLTA".

KZAZ vendos për fillimin e procesit të numërimit të votive vetëm pasi ka marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votive dhe kutitë e materialeve të votimit nga të gjitha QV-të

## 2-Fillimi i procesit të numërimit të votave

**KZAZ-ja** drejton dhe kontrollon procesin e numërimit të votave në VNV [KZ, n.116-122].
**KZAZ-ja**, pas veprimeve paraprake, të sipërcituara **merr vendim** për fillimin e procesit të numërimit të votave.
**Sekretari i KZAZ**-së shënon në
- **Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së** dhe
- **Regjistrin e Vendimeve të KZAZ**-së, **vendimin** dhe **orën e saktë** të fillimit të procesit të numërimit të votave.

✓ Kutitë e votimit të pranuara si të rregullta në cdo rast u nënshtrohen procedurave të hapjes;
✓ Procesi i numërimit vazhdon pa ndërprerje deri në numërimin e të gjitha kutive të pranuara;
✓ Procesi i numërimit ndërpritet vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal të numërimit.

**Kujdes!** **REFUZIMI I NUMËRIMIT TË VOTAVE ÇON NË SHKARKIMIN E MENJËHERSHËM TË PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR NUMËRIMIN OSE TË ANËTARËVE TË KZAZ-SË REFUZIMI PËR TË NUMËRUAR KUTINË E PRANUAR SI TË RREGULLT PËRBËN VEPËR PENALE DHE DËNOHET ME BURGIM.**

Shkaqet e ndërprerjes përfshirë vendimin për rifillimin e numërimit argumentohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së.

### 3-Radha e numërimit

Numërimi nis fillimisht me votat për **subjektet zgjedhore për të gjitha QV-të në rang ZAZ-je;**

Numërimi i votave për kandidatët e listave shumëemërore të partive politike e koalicioneve zgjedhore, fillon vetëm pasi ka mbaruar numërimi i votave për subjektet zgjedhore të të gjitha QV-ve të ZAZ-së dhe është miratuar me vendim Tabela Përmbledhëse e Rezultateve për ZAZ-në.

**Kujdes!** Numërimi i votave për kandidatin e parapëlqyer nis **vetëm** pasi ka mbaruar numërimi i votave për **subjektet zgjedhore sipas procedurës të sqaruara në vijim.**

### 4 - Veprimet paraprake të GN-it

Nën drejtimin e kryetarit apo të një anëtari të KZAZ-së i ngarkuar nga KZAZ-ja,
**Sekretari i GN-it:**

- **merr** me radhë dh**e** sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit**, nga stiva e kutive të votimit,** kutinë e votimit me fletët e votimit të **vetëm** një qendre votimi, dhe e vendos pranë tryezës së GN-së përkatës.
- **merr nga sekretari i KZAZ**-së, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV.
- vendos/ ngjit në vendin e paracaktuar nga KZAZ në tavolinë etiketën adezive dhe shkruan numrin e qendrës së votimit që numërohet

Në dosje ndodhen:

- Procesverbali i dorëzimit të kodeve të sigurisë së vulave, **Model KZAZ 23**,
- Procesverbali "Për paisjen nga KZAZ me materiale zgjedhore të KQV-së", **Model KZAZ 22**;
- Modeli krahasues i vulës së kryetarit të KQV-së përkatëse.

### 5. Hapja e kutisë së votimit

**Numëruesi i parë:**

- vendos mbi tryezë **kutinë me fletët e votimit** për subjektet zgjedhore;
- këput vulat me kodet e sigurisë dhe **e hap atë**
- Ekspozon në ekran për jo më pak se 2 sekonda në faqen anësore ku është vendosur etiketa me numërin e qendrës së votimit.





**!** Për lehtësi të procedurës, **Kodi i fundit i sigurisë, që mbyll hapësirën e kapakut, ku janë hedhur fletët e votimit, nuk këputet.**

**Anëtarët e GN-it:**

- **nxjerrin** nga kutia me fletët e votimit , **Procesverbalin e Mbylljes së Votimit,** Model **KQV 8 dhe raportin e mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve i printuar nga PEI.**
- **verifikojnë** nëse procesverbali i Mbylljes së Votimit është plotësuar saktë.

Nëse **Model KQV 8** është plotësuar **saktë**, **numëruesi i parë** dhe **anëtarët e GN-it** vazhdojnë procedurat për numërimin e votave dhe vlerësimin e fletëve të votimit.

**Rasti 1. Procesverbali I Mbylljes së votimit, Model KQV 8, dhe raporti i** mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve i printuar nga PEI **gjendet në kutinë e votimit.**
**Procesverbali mbylljes së votimit është i plotësuar saktë.**



## 6. Numërimi i fletëve të votimit



**Numëruesi i parë dhe anëtarët e GN-it** hapin në mënyrë të plotë çdo fletë votimi, në anën e pasme të fletës nga ana e sipërme për të verifikuar praninë e vulave në fletën e votimit;

**Numëruesi i parë**

- Numëron fletët e votimit të stivuara dhe ia bën të ditur shifrën anëtarëve të GN-it si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.
- Verifikon shifrën e deklaruar në Model KQV 08 me shifrën e numrit të zgjedhësve, që kanë votuar, të pasqyruar në **raportin e mbylljes së identifikimit elektronik nëpërmjet PEI** ;

❖ **Nëse shifra nuk përputhet** GNV i referohet shifres të raportit të mbylljes së identifikimit elektronik PEI, *perveç rasteve kur procedura e votimit është zhvilluar edhe në mungesë të PEI,* ose **kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të GN-it,**
numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit;

❖ **Nëse pas verifikimeve** konstatohet mospërputhje, GNV-ja:
njofton KZAZ-në, me ngritjen e dorës, pa lëvizur nga vendi.
Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV-së, deri sa
KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë.

\- Në rast se KZAZ-ja konfirmon pasaktësinë, **Sekretari** i saj e pasqyron atë në Procesverbalin e Konstatimit.

! **KZAZ**-ja,
**vetëm** pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në Procesverbalin e Konstatimit,
- merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave nga GNV-ja dhe
- ia bën vendimin menjëherë të ditur GNV-së.

## 7.Vlerësimi i fletëve të votimit

GNV-ja, bën ndarjen e hapësirës së tavolinës së numërimit, duke përcaktuar vendet e veçanta për fletët e votimit: të vlefshme, të pavlefshme, të kontestuara.

GNV-ja përcakton vend të veçanta për grupime të fletëve të votimit të vlefshme për cdo subjekt zgjedhor.

**Numëruesi i parë** i vendos një nga një fletët e votimit në kamerën regjistruese, fillimisht **nga faqja e pasme**, **jo më pak se 3 sekonda**, në mënyrë që **të shihen qartë** në monitor:

- **Vula e KQV**-së dhe

- **Vula e Kryetarit të KQV**-së.

**Gjatë shfaqjes të fletës së votimit, nga faqja e pasme,**

**Numëruesi i Parë** verifikon nëse fleta e votimit**:**
- ka të njëjtën **madhësi**, **formë** dhe **ngjyrë**, me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja.
- është vulosur me **vulën e KQV**-së dhe me **vulën e Kryetarit të KQV**-së.
- ka **shënime**, **shenja** apo **nënshkrime**, që bëjnë të mundur identifikimin e zgjedhësit.

**Gjatë kryerjes së kësaj procedure**, numëruesi i parë, **shprehet me zë të lartë vetëm**
- për **fletët e votimit,** të cilat i konsideron **të pavlefshme** gjatë vlerësimit **nga faqja e pasme**.
- **Në rast se** ndonjë nga **anëtarët e GN-it** ose ndonjë prej **vëzhguesve të subjekteve zgjedhore**, nuk është dakort me **vlerësimin e mësipërm, numëruesi i parë e vendos fletën e votimit të kundërshtuar** në vendin e caktuar për **fletet e votimit të kontestuara** dhe **vijon** me **fletën tjetër të votimit**.
  Kjo fletë votimi, **do të vlerësohet përsëri** nga GN-it në momentin e rivlerësimit të votave.
- **Në rast se** gjatë kryerjes së kësaj procedure, **për fletën e votimit të vlerësuar e pavlefshme**, nuk ka patur kontestime, atëherë **ajo vendoset në vendin e caktuar për votat e pavlefshme** mbi tavolinën e punës së GNV-së.

! **VLERËSIMI I VOTAVE FILLON MENJËHERË PAS VLERËSIMIT TË FLETËS SË VOTIMIT NGA FAQJA E PASME.**

## 8.Vlerësimi i votave



Fletët e votimit ndahen nga GN-it në
- **Vota të VLEFSHME**,
- **Vota të PAVLEFSHME,**
- **Vota të Kontestuara.**

Vota të vlefshme janë **vetëm** fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe/ osenjërin nga kandidatët e tij në fletën e votimit.

! *Kur është votuar për më shumë se një kandidat të të njëjtit subjekt zgjedhor, vota i llogaritet vetëm subjektit zgjedhor.*

**Disa shembuj të fletëve të votimit të vlefshme** i gjeni në fund **të këtij udhëzimi.**

Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit në të cilat, nuk ka asnjë nga rastet e pavlefshmërisë të parashikuara në nenin 117, pika 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.



Në çdo rast GN-it për numërimin e votave për subjektet zgjedhore duhet të përdorë **mbajtëse me ndarje**, me gjerësinë e fletës së votimit, me të cilën e ka pajisur KQZ, **duke identifikuar në mënyrë të qartë numrat e subjekteve zgjedhore në mbajtëse, ku i korrespondon numri i subjektit zgjedhor në fletën e votimit.**

Në rast se anëtarët e Grupit të Numërimit dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore në numërim, janë dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, fleta e votimit ndahet sipas vlerësimit dhe vendoset në vendin e caktuar për partinë politike, koalicionin apo kandidatin e propozuar nga zgjedhësit për të cilin është votuar. Numëruesi i parë merr fletën tjetër të votimit dhe ndjek të njëjtën procedurë.

**VLERËSIMI I VLEFSHMËRISË SË VOTAVE KA SI SYNIM TË IDENTIFIKOJË, SA MË SHUMË QË TË JETË E MUNDUR, QËLLIMIN E VOTUESIT.**

**GNV**-ja, në hapësirën e tavolinës së numërimit të caktuar për votat e vlefshme, **përcakton** vende të veçanta (sipas rastit, duke respektuar radhën e numërimit) për grupime të fletëve të votimit të vlefshme për **çdo subjekt zgjedhor**:

1. partitë politike, koalicionet, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit deri në përfundimin e numërimit të tyre).
2. Kandidatët e subjekteve zgjedhore, vetëm në rastin e numërimit të votave të kandidatëve (pas nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për çdo QV dhe Tabelës Përmbledhëse partitë politike, koalicionet, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit).

**Numëruesi i parë** i GN-it, **në rast se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e pavlefshmërisë se votës të parashikuar** në KZ, neni 117/3, dhe në fletën e votimit:



- nuk janë bërë shënime në favor ose disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
- është votuar qartësisht **vetëm** për njërin nga subjektet zgjedhore;
- nuk është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
- nuk është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor;
- është e qartë se për kë është votuar; ose
- nuk është votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit;

✓ **çmon** dhe pastaj **u propozon për vlerësim** anëtarëve të tjerë të GN-it, **se cilit** subjekt zgjedhor **i është hedhur vota**.

✓ **është i detyruar**
  - **t'ia tregojë** çdo fletë votimi **anëtarëve të GN-it** dhe
  - **të vendosë** çdo fletë votimi në kamerën regjistruese, **jo më pak se 4 sekonda**, në mënyrë që të shikohet qartësisht në monitor shenja, e cila tregon vullnetin e votuesit.

**! Gjatë shfaqjes së fletës së votimit në kamerën regjistruese numëruesi i parë i Grupit të Numërimit, bën vlerësimin e votës me zë të lartë.**

**Në rast se** anëtarët e GN-it dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore në numërim **janë dakort** me vlerësimin e numëruesit të parë, **fleta e votimit** ndahet **sipas vlerësimit** dhe **vendoset** në vendin e caktuar për subjektin zgjedhor për të cilën është votuar.

Numëruesi i parë merr fletën tjetër të votimit dhe vazhdon procedurën.

**! Vota të pavlefshme** janë fletët e votimit kur:

a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja;
b) fletës së votimit i mungojnë një nga vulat e parashikuara në nenin 103 të Kodit Zgjedhor;
c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;
ç) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;
d) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;
dh) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore dhe/ ose kandidatët në fletën e votimit;
e) është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor;
ë) nuk është e qartë se për kë është votuar; ose
f) zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.

## 9. Kontestimi dhe Rivlerësimi i Votës

Në rast se ndonjëri nga **anëtarët e GN-it** ose **çdo vëzhgues** i subjekteve zgjedhore,
**nuk është dakort** me vlerësimin e numëruesit të parë, ky i fundit **e vendos** fletën e votimit të kundërshtuar në vendin e përcaktuar **për fletët e votimit të kontestuara** dhe **vijon** me fletën tjetër të votimit.
**Kontestimi i votës** bëhet duke ngritur dorën e duke thënë "**NUK JAM DAKORT**".
Në përfundim të vlerësimit të fletëve të votimit të kutisë përkatëse të votimit,
**GN**-it **rivlerëson fletët e votimit të kontestuara**.

**GJATË VLERËSIMIT TË VOTAVE, NË ASNJË RAST DHE PËR ASNJË ARSYE FLETËT E VOTIMIT NUK SHFAQEN MË SHUMË SE NJË HERË NË KAMERA.**

**RIVLERËSIMI NUK I NËNSHTROHET PROCESIT TË SHFAQJES SË FLETËVE TË VOTIMIT TË KONTESTUARA NË KAMER.**

**Gjatë procesit të rivlerësimit**, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore **nuk kanë të drejtë të kontestojnë** vlerësimin e votës **dhe** as të kërkojnë rishfaqjen e votave në monitor. Në çdo rast, vëzhguesit informohen për përfundimin e rivlerësimit.

**Në rast se edhe pas rivlerësimit** nga **GNV**-ja, mbeten ende fletë votimi të kontestuara (ka fletë votimi të kontestuara nga **të paktën një anëtar i GNV**-së), atëherë GNV-ja, **numëruesi i parë** ose **çdo anëtar** thërret KZAZ-në për vlerësimin e fletëve të votimit të kontestuara të asaj kutie.

**KZAZ**–ja
- **bën** në çast **vlerësimin e secilës fletë votimi të kontestuar** dhe
- **merr vendim** në lidhje me të, duke e vlerësuar atë, votë të vlefshme apo votë të pavlefshme.

**Rezultati i shpallur nga KZAZ**–ja shënohet në **Librin e Protokollit të Mbledhjeve** të KZAZ–së nga Sekretari i KZAZ-së dhe përfshihet në **tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit**, Model **KZAZ 29**, sipas rastit Model **KZAZ 30 (**në rastin kur bëhet numërimi i votave për kandidatët e listave shumemërore**)**, që plotëson GNV-ja.

Për secilën **fletë të kontestuar**,
**numëruesi i parë** i GN-it shënon në
pjesën e prapme të saj, qartë, arsyet e kontestimit.




**GNV**
shënon numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara për QV–në përkatëse në Procesverbalin, **Model GNV 1**.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PROCESVERBAL
PËR NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË FLETËVE TË VOTIMIT TË KONTESTUARA

KZAZ
GNV nr.

PROCESVERBAL
Për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara
Datë:

**Baza ligjore:** Neni 118 paragrafi 5, të ligjit 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

**Në përfundim të numërimit të fletëve të votimit, të QV nr.________ :**

Numri i përgjithshëm i fletëve të votimit të kontestuara është

(me numër) (me fjalë)

**Për Grupin e Numërimit:**

| Nr | Emër Mbiemër | Pozicioni | Firma |
|---|---|---|---|
| 1 | | Numëruesi i parë | |
| 2 | | Sekretar | |
| 3 | | Anëtar | |
| 4 | | Anëtar | |

MODEL GNV 1

Miratuar me Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.37, datë 17.12.2020




**Në përfundim të nxjerrjes së rezultatit për QV përkatëse**,

- ✓ **fletët e votimit** të cilësuara **si të kontestuara** dhe
- ✓ procesverbali përkatës, **Model GNV 1 futen** në zarfin e "FLETËVE TË VOTIMIT TË KONTESTUARA", Model Z 04.

## 10. Numërimi i votave për subjektet zgjedhore

Pas numërimit dhe vlerësimit të votave për çdo kuti votimi,
**Numëruesi i parë**

- numëron votat për çdo subjekt zgjedhor, duke filluar sipas renditjes së subjekteve në fletën e votimit.
- **pas çdo numërimi,** ia bën të ditur, shifrën, anëtarëve të GN-it dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.

**Në rast se** kërkohet nga ndonjë anëtar i GN-it, **numëruesi i parë** është i detyruar të rifillojë **edhe një herë numërimin e votave** për atë subjekt.

**Në rast se, edhe pas këtij numërimi të dytë** ka përsëri **kundërshtime**, numëruesi i parë ose anëtari kundërshtues, **njofton** KZAZ–në **nëpërmjet ngritjes së dorës**. Ngritja e dorës **pezullon çdo veprim të mëtejshëm** të GNV-së, deri në marrjen e vendimit nga KZAZ–ja.

**KZAZ–ja** numëron në vend votat për subjektin zgjedhor, objekt kundërshtimi dhe urdhëron Grupin e Numërimit të shënojë shifrën e vendosur prej saj në tabelën e rezultateve për atë qendër votimi, Model **KZAZ 29**, që plotëson GNV-ja.

**Fleta e votimit**, në të cilën **është votuar qartësisht** vetëm **subjekti zgjedhor**, dhe që **nuk është përzgjedhur asnjë kandidat i listave shumemërore**, ***numërohet** dhe **pasqyrohet*** tek Procesverbali **Model 29/1** për çdo QV, i cili nënshkruhet nga anëtarët e GN.

Në përfundim të numërimit të votave dhe hedhjes të të dhënave të procesverbalit **Model 29/1** për të gjitha subjektet të ZAZ-së, **plotësohet procesverbali përmbledhës për votat e vlefshme për partitë politike dhe koalicione kur nuk ka votim parapëlqyes për kandidatët e listave shumemërore Model 30/1**, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe Zv. Kryetari i KZAZ-së.

Fletët votimi, në të cilat është votuar qartësisht, **vetëm** për subjektin zgjedhor **futen** në një zarf të veçante **model 06**, ku shënohet **emri i subjektit zgjedhor**, dhe **nuk hapen më gjatë procesit të numërimit të votave të kandidatit të listave shumemërore**.

**! Numëruesi i parë** dhe **sekretari i GN-i**t janë **përgjegjës për zbatimin e detyrimeve** që lindin nga kontestimi i fletëve të votimit. Shkelja e këtyre detyrimeve, **ndëshkohet me gjobë** sipas n.171 të KZ.

***Rasti 2:*** Procesverbali Mbylljes së Votimit, Model KQV 8, nuk është shoqëruar **raporti i** mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve i printuar nga PEI, i cili nuk gjendet në kutinë e votimit. Kutia e materialeve per te kerkuar raportin e PEI nuk hapet kur votimi është bërë pa PEI.

dhe/ ose Procesverbali i Mbylljes së Votimit, Model KQV-08, nuk gjendet në kutinë e fletëvë të votimit ose nuk është plotësuar në mënyrën e duhur

KZAZ plotëson procesverbalin e konstatimit dhe vepron si më poshtë:

Në këtë rast hapet kutia e materialeve zgjedhore.

Në rast se GNV ose vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që konstatojnë mungesën e procesverbalit të mbylljes së votimit ose të raportit të mbylljes së PEI, njoftojnë KZAZ me ngritje të dorës. Procedura pezullohet derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë dhe merr vendim për hapjen e Kutisë së materialeve të votimit.

### 11. Hapja e kutisë së materialeve të votimit

Pas njohjes me vendimin e KZAZ-së, **numëruesi i parë:**

- vendos **kutinë me fletët e votimit**, numërimi i së cilës është pezulluar, **pranë tavolinës së numërimit**;
- merr **kutinë e materialeve të votimit të qendrës së votimit përkatëse**, për të vazhduar procedurat e verifikimit të materialit të votimit.
- këput **vulat me kodet e sigurisë** të kutisë së materialeve të votimit dhe e hap atë [kutinë].

**Në rastet kur GN-it** ose **cilido nga vëzhguesit** e subjekteve zgjedhore konstaton **parregullsi** në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit**,** Model **KQV 8, apo mungesë të të dhënave të raportit të** mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve i printuar nga PEI i nënshkruar dhe vulosur nga gjithë anëtarët e KQV-së.

- njofton **menjëherë KZAZ-në** për problemin, duke ngritur dorën dhe pa lëvizur nga vendi.

Ngritja e dorës **pezullon** çdo veprim të mëtejshëm të GN, derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë.

Në rast se KZAZ-ja konfirmon pasaktësinë ose parregullsinë, e pasqyron atë në Procesverbalin e Konstatimit dhe **vetëm** pas regjistrimit të këtyre fakteve, **KZAZ**-ja merr **vendim** për:

- vazhdimin e procedurave të verifikimit të materialit të votimit/zgjedhore ose
- pezullimin e numërimit të votave nga GN-it.

**Vendimi** i marrë nga **KZAZ**-ja i bëhet i ditur **menjëherë GNV**.

**Në rastet kur GN-it** ose **cilido nga vëzhguesit** e subjekteve zgjedhore konstaton **se** Procesverbali i Mbylljes së Votimit**, Model KQV 8, mungon në kutinë e votimit:**

- njofton **menjëherë KZAZ-në** për problemin, duke ngritur dorën dhe pa lëvizur nga vendi.

Ngritja e dorës **pezullon** çdo veprim të mëtejshëm të GN, derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë.

Në rast se KZAZ-ja konfirmon mungesën (parregullsinë apo pasaktësinë) e procesverbalit Model KQV 8 në kutinë e votimit me fletët e votimit, e pasqyron atë në Procesverbalin e Konstatimit dhe **vetëm** pas regjistrimit të këtyre fakteve, **KZAZ**-ja merr **vendim** për:

- vazhdimin e procedurave të verifikimit të materialit të votimit/zgjedhore ose
- pezullimin e numërimit të votave nga GN.

**Vendimi** i marrë nga **KZAZ**-ja i bëhet i ditur **menjëherë GNV**.

**KUTIA E MATERIALEVE TË VOTIMIT HAPET VETËM NË RASTET KUR PROCESVERBALI I MBYLLJES SË VOTIMIT, MODEL KQV 8,**

- **MUNGON NË KUTINË ME FLETËT E VOTIMIT OSE**
- **KUR TË DHËNAT NUK JANË PLOTËSUAR SAKTË, sipas Kodit Zgjedhor, neni 113, NË PROCESVERBALIN E MBYLLJES SË VOTIMIT**

**MUNGON RAPORTI I MBYLLJES SË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE I PRINTUAR NGA PEI I NËNSHKRUAR DHE VULOSUR NGA GJITHË ANËTARËT E KQV-SË NË RAST SE PROCEDURA ËSHTË ZHVILLUAR ME PEI.**

### 11.1. Procesverbali për Mbylljen e Votimit gjendet në kutinë e materialeve të votimit

**Në fillim GN**-it verifikon:

- nëse **në kutinë e materialeve të votimit** ndodhet **Procesverbali për Mbylljen e Votimit**, **MODEL KQV 8**, dhe
- nëse **është i plotësuar** në mënyrë të rregullt
- Nëse ndodhet kopja e **raportit të** mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve i printuar nga PEI i nënshkruar dhe vulosur nga gjithë anëtarët e KQV-së

**Kujdes!** Nëse **GN:**

- **e gjen** Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, **Model KQV 8**, në kutinë e materialeve të votimit, dhe
- **e verifikon atë të** plotësuar saktë, **ia jep** KZAZ-së, e cila pasqyron faktet në Procesverbalin e Konstatimit**.**

Në këtë rast GN-it, njofton KZAZ-në, e cila e pajis me vulat me kodet e sigurisë për mbylljen e Kutisë së Materialeve të Votimit.

**Sekretari i GN**, pasi i ka marrë vulat me kodet e sigurisë nga KZAZ

- shënon **numrat e kodeve** në Procesverbalin e GN-it për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit, **Model GNV 1;**
- fut **Procesverbalin e GN-it, Model GNV 1**, në kutinë e materialeve të votimit, dhe
- mbyll **Kutinë e Materialeve të Votimit** me vulat me kode sigurie.
- i dorëzon KZAZ-së kopje të **Procesverbalit, Model GNV 1** së bashku me **Procesverbalin për Mbylljen e Votimit**, Model **KQV 8**.

! Në rastin kur **Procesverbali Model KQV 8 apo raporti i mbylljes së identifikimit elektronik** gjendet në kutinë e materialeve të votimit,

- ✓ **KZAZ fotokopjon** dhe **administron procesverbalin Model KQV 8 / raportin e mbylljes PEI** (kopja e administruar do të shërbejë në rast se në kutinë e votimit për të kësaj QV do të konstatohet mungesa e procesverbalit Model KQV 8 dhe/ ose raportit të mbylljes së identifikimit elektronik).
- ✓ GN të rivendos origjinalin në Kutinë e materialeve të votimit.

Ky fakt shënohet nga Sekretari i KZAZ-së në LPM dhe Procesverbalin e Konstatimit.

Sekretari i KZAZ-së, **shënon**
**numrat e kodeve** të vulave të sigurisë, të pasqyruara nga GN-it në **procesverbalin Model GNV 1,** në **Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së**.

Më pas, **numëruesi i parë** :

- vendos **kutinë e materialeve të votimit** pranë tavolinës së numërimit;
- merr **kutinë e votimit** të QV-së përkatëse, **numërimi i së cilës ishte pezulluar**.

**GN** vazhdon me numërimin e votave, sipas procedurave të këtij kreu në pikën:
**4. Numërimi i votave**

**5. Vlerësimi i fletëve të votimit**
**6. Vlerësimi i votave**
**7. Kontestimi dhe Rivlerësimi i Votës**
**8. Numërimi i votave për subjektet zgjedhore**.

Më pas**, GN** ndjek këto procedura (në rastin kur është përfunduar procesi i verifikimit në kutinë e materialeve të votimit apo në rastin kur në kutinë e votimit janë gjendur procesverbali i mbylljes KQV-08):

- **verifikon nëse në kuti ndodhen:**
  - ✓ Zarfi identifikimit biometrik (me vërtetime të identifikimit elektronik)
  - ✓ Zarfi "FLETË VOTIMI TË PAPËRDORURA";
  - ✓ Zarfi "FLETË VOTIMI TË DËMTUARA";
  - ✓ Lista e Zgjedhësve, përfshirë edhe Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve, me dokumentacionin bashkëlidhur, nëse ka;
  - ✓ Vula e KQV-së;
  - ✓ Vula e Kryetarit të KQV-së;
  - ✓ Vulat me kodet e sigurisë të papërdorura;
  - ✓ Vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara, nëse ka;
  - ✓ Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së dhe origjinali i vendimeve të marra nga KQV;
  - ✓ Sipas rastit: raporti i mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve i printuar nga PEI i nënshkruar dhe vulosur nga gjithë anëtarët e KQV-së ose procesverbalin Model KQV-08

Në vijim, **Numëruesi i parë:**

- **krahason vulën** e Kryetarit të KQV-së me modelin krahasues dhe mendimin e tij ua bën të ditur anëtarëve të grupit;
- **numëron fletët e votimit të papërdorura** dhe **ia bën të ditur** shifrën anëtarëve të **GN**-it dhe **vëzhguesve** të subjekteve zgjedhore. **Nëse kërkohet** rinumërim nga **ndonjë prej anëtarëve të GN**-it, **numëruesi i parë** është i detyruar **të rifillojë edhe një herë numërimin** e fletëve të votimit **të papërdorura**.
- **numëron fletët e votimit të dëmtuara** dhe **ia bën të ditur** shifrën anëtarëve **të GN**-it dhe **vëzhguesve** të subjekteve zgjedhore. **Nëse kërkohet** rinumërim nga **ndonjë prej anëtarëve të GN**-it, **numëruesi i parë** është i detyruar **të rifillojë edhe një herë numërimin** e fletëve të votimit të dëmtuara.
- **numëron zgjedhësit që kanë votuar**,
  - o Në rastin kur procesi i votimit është zhvilluar pa PEI: N**umëron** nënshkrimet e tyre në listën e votuesve, përfshirë edhe ata në regjistrin e posaçëm dhe **ia bën të ditur** shifrën anëtarëve të **GN**. **Nëse shifrat nuk përputhen** ose **nëse kërkohet** rinumërim **nga ndonjë prej anëtarëve të GN**, **numëruesi i parë** është i detyruar **të rifillojë edhe një herë numërimin** e zgjedhësve që kanë votuar.
  - o Në rastin kur procedura është zhvilluar pjesërisht me PEI pas ndërprerjes së funksionimit, dhe nuk ka printuar raport me të dhënat, ndiqet e njëjta procedurë si më sipër. (Vërejtjet shënohen në Procesverbalin e Konstatimit**, nga KZAZ-ja,** pas njoftimit nga GN).
  - o Në rastin kur procedura është zhvilluar me funksonimin e PEI-it, numrin e zgjedhësve që kanë votuar sipas raportit të mbylljes së identifikimit elektronik të printuar nga PEI, të nënshkruar nga anëtarët e KQV-së dhe të vulosur
- **hedh të dhënat në tabelën e rezultateve të qendrës së votimit**, Model KZAZ-**29,** për numrin të fletëve të votimit sipas Procesverbalit "Për paisjen nga KZAZ-ja me materiale zgjedhore të KQV-së", **Model KZAZ 22.**

**Sekretari i GN**-it, vazhdon procedurën për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit, si në ***Pikën 10.1.***

Sekretari i KZAZ-së, **shënon numrat e kodeve** të vulave të sigurisë në **Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së**.

Më pas, **numëruesi i parë**:

- vendos **kutinë e materialeve të votimit** pranë tavolinës së numërimit;
- merr **kutinë e votimit** të QV-së përkatëse, **numërimi i së cilës ishte pezulluar**.

**GN** vazhdon me numërimin e votave, sipas procedurave të këtij kreu në pikën:

**6. Numërimi i votave**
**7. Vlerësimi i fletëve të votimit të vlefshme dhe të pavlefshme**
**8. Vlerësimi i votave**
**9. Kontestimi dhe Rivlerësimi i Votës**
**10. Numërimi i votave për subjektet zgjedhore.**

! Gjatë procesit të numërimit të kutisë së votimit me fletët e votimit për subjektet zgjedhore, **KZAZ bën pjesë të dosjes së QV përkatëse kopjen e procesverbalit Model KQV 8 dhe/ ose raportin e mbylljes së identifikimit elektronik PEI**. Përdorimi i kopjes së administruar do të shmangë:

- Hapjen ose rihapjen e kutisë së materialeve të votimit, në rastet kur **procesverbali Model KQV 8** dhe/ ose raporti i mbylljes i identifikimit elektronik nuk do të gjendet në këtë kuti/kutinë e votimit me fletët e votimit për QV përkatëse.
- Kryerjen e procedurave me materialet e votimit të gjendura në kutinë e materialeve të votimit për plotësim të të dhënave në tabelën e rezultateve të QV-së.

**Sekretari i KZAZ-së**

- shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve numrin e QV-së së numëruar për:
  - subjektin që i korrespondon zarfi përkatës.

## IV. TRANSMETIMI ELEKTRONIK DHE NXJERRJA E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

! Pas plotësimit të tabelës së rezultateve të çdo QV-je, **KZAZ**-ja dërgon elektronikisht nëpërmjet sistemit në KQZ tabelën e rezultateve te zgjedhjeve të çdo QV-je.

### 1. Veprimet para plotësimit të Tabelës së Rezultateve të zgjedhjeve për QV për subjektet

✓ Përpara plotësimit të Tabelës së Rezultateve të Votimit, për subjektet zgjedhore/kandidatët e listave shumemërore të subjekteve për **Kuvend** nga anëtarët e GN-it, **KZAZ**-ja i jep **sekretarit të GNV-së**:

❖ Tabelën e Rezultateve të Votimit të QV-së përkatëse **Model KZAZ 29 format A3** për subjektet zgjedhore dhe Model KZAZ 30 Format A4 për kandidatët e listave shumemërore. Për Qarkun Tiranë Modeli KZAZ 30 është në format A3;

❖ Vulat me kodet e sigurisë, të cilat shërbejnë për mbylljen e kutisë së votimit;

❖ Procesverbalin e GNV-së për pasqyrimin e numrit të përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara, **MODEL GNV 1**.

❖ Zarfat **e emërtuar**:

- Zarfi i fletëve të votimit të vlefshme, **Z.06**, për çdo subjekt zgjedhor, për të cilën është votuar qartësisht vetëm subjekti, kandidat i propozuar nga zgjedhësit

- Zarfi i fletëve të votimit të vlefshme për subjektin në tërësi, **Z.08**, në të cilin futet zarfi **Z.06** me fletët e votimit që kanë vota vetëm për partinë apo koalicionin dhe votat në të cilën është votuar edhe për kandidatët e tij.
- Zarfi i fletëve të votimit të kontestuara, **Z.04**
- Zarfi i fletëve të votimit të pavlefshme, **Z.05**

### 2.Plotësimi i tabelës dhe transmetimi i rezultateve paraprake të Zgjedhjeve (subjekte/ kandidatë)

✓ **Numëruesi i Parë,** së bashku me anëtarët e tjerë të GNV-së plotëson **tabelën e rezultateve** për atë qendër votimi, **Model KZAZ 29.**

**!** Në Tabelën Rezultateve të QV-së, përkatëse, krahas rezultateve për çdo subjekt zgjedhor, duhet të plotësohen nga GN:

✓ numrin e zgjedhësve që kanë votuar;
✓ numrin e fletëve të votimit të papërdorura;
✓ numrin e fletëve të votimit të dëmtuara;
✓ numrin e fletëve të votimit të gjetura në kuti;
✓ numrin e votave të pavlefshme;
✓ numrin e votave të vlefshme;
✓ numrat e kodeve të vulave të sigurisë, të cilat përdoren për mbylljen [vulosjen] e kutisë së votimit me votat e numëruara;
✓ kundërshtimet e secilit anëtar të GN, nëse ka;
✓ data e plotësimit të tabelës;

✓ Anëtarët e GNV-së shkruajnë emrin, atësinë, mbiemrin dhe firmosin përbri funksionit.

Para plotësimit të tabelës së rezultateve të QV-së përkatëse, GNV kontrollon dhe sigurohet që kushtet që përdor aplikacioni kompjuterik të zbatohen si më poshtë:

**a.** Numri i zgjedhësve që kanë votuar (sipas shifrës shënuar në PV Model KQV 8 ose raportin e mbylljes së identifikimit elektronik), duhet të jetë jo më i madh se numri i zgjedhësve në listën e zgjedhësve të asaj QV-je.
**b.** Numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti duhet të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve që kanë votuar;
**c.** Numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti të jetë i barabartë me shumën e votave të vlefshme me votat e pavlefshme, kur ka të tilla;
**d.** Numri i votave të vlefshme të jetë i barabartë me shumën e votave të vlefshme të shpërndara për subjektet zgjedhore.
**e.** Në rastin e plotësimit të tabelave të rezultateve për QV për kandidatët e listave shumemërore të partive dhe koalicioneve duhet që shuma e votave të vlefshme të kandidatëve për deputet të një partie politike apo një koalicioni zgjedhor të mos jetë më e madhe se votat e vlefshme të fituara nga subjekti përkatës.

Tabela e rezultateve e plotësuar me shkrim dore dhe e firmosur nga anëtarët e GN vendoset ndënë kamera dhe shfaqet në monitor për jo më pak se 4 sekonda.

Nëse ndonjë nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore ka kundërshtime në lidhje me rezultatet e pasqyruara në tabelë, ato shënohen në Librin e Protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së nga sekretari i saj.

Tabela e rezultateve për QV-në, e printuar në 5 kopje dhe e firmosur nga anëtarët e GN-së, pas verifikimit të saktësisë u jepet, kopja e parë me shenjë dalluese nga të tjerat, KZAZ-së dhe të tjerat anëtarëve të GN-së.

### 3. Hedhja dhe Transmetimi elektronik i të dhënave të pasqyruara në Tabelën e Rezultateve të QV-së

Hedhja e informacionit në aplikacionin kompjuterik si dhe përcjellja e informacionit në KQZ, bëhet nga Operatori **nën drejtimin dhe përgjegjësinë** e sekretarit të KZAZ-së.

**Tabela e rezultateve për QV** për subjektet/ kandidatët e listave shumemërore, **e plotësuar me shkrim dore nga GN**, **Model KZAZ 29/ KZAZ 30** i dorëzohet **nga numëruesi i parëmenjëherë pas shfaqjes në monitor** dorazi sekretarit të KZAZ-së.

Sekretari i KZAZ-së, pasi ka marrë nga GN-ja tabelën e rezultateve të një QV-je, për subjektet zgjedhore/ kandidatët, të plotësuar me shkrim dore dhe firmosur, sipas modelit KZAZ-29/ KZAZ 30, ia jep atë operatorit të hedhjes së të dhënave dhe veprohet si më poshtë:

a) Operatori i hedh këto të dhëna në aplikacionin elektronik në kompjuter dhe printon në letër në 5 kopje informacionin që ka në formë elektronike. Menjëherë pas printimit aplikacioni elektronik automatikisht bëhet i pa editueshëm/i pa shkrueshëm.

b) Tabelat e printuara nga forma elektronike i dorëzohen GN-së nga sekretari i KZAZ-së, për të verifikuar saktësinë e të dhënave.
   i. Në rast se informacioni i dhënë me shkrim dore nga GN-ja dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të njëjta, pasi firmosen tabelat e printuara nga anëtarët e GN-së, sekretari i KZAZ-së fut ne sistem kodin personal te tij dhe udhëzon operatorin të dërgojë në rrugë elektronike rezultatet në KQZ.
   ii. Në rast se informacioni i dhënë me shkrim dore nga GN-ja dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të ndryshme, numëruesi i parë i GN-së bën korrigjimet me shkrim dore në një nga fletët e printuara dhe kjo fletë firmoset nga anëtarët e GN-së.
   iii. Sekretari i KZAZ fut ne sistem kodin e tij duke e kthyer aplikacionin elektronik në të editueshëm/të shkrueshëm dhe udhëzon operatorin të bëjë korrigjimin e të dhënave të pasakta dhe përsëritet procedura e printimit, verifikimit dhe më pas, kur është arritur saktësia, dërgimit në KQZ.

Kujdes! Në rast se cenohen kushtet e përmendura në këtë kre, pika 2 “a” dhe 2 “b” më sipër dhe pas verifikimeve që bën sekretari i KZAZ-së rezulton se mospërputhja vjen nga ndonjë gabim njerëzor i bërë në VNV, lejohet korrigjimi në sistem i shifrave;

Në rast se cenohen kushtet e përmendura në këtë kre, pika 2 “a” dhe 2 “b” më sipër dhe pas verifikimeve që bën KZAZ-ja rezulton se mospërputhja nuk vjen si pasoje e gabimeve njerëzore, por pasqyron të dhënat që janë në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit Model KQV 08/ Raportit të mbylljes së identifikimit elektronik, aplikacioni kompjuterik nuk lejon vazhdimin e procesit.

Operatori në këtë rast kontakton me telefon KQZ-në për ti dhënë të drejtën për të vazhduar procesin, duke bërë në sistem shënimin “mospërputhje”.

Në rast se cënohen  kriteret e përshkruara pikën 2 “c” dhe 2 “d” më sipër, aplikacioni kompjuterik nuk lejon për asnjë arsye cenimet e këtyre të rregullave.

Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit e numërimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve për subjektet prej GN-ve.

Tabela e rezultateve për QV-në e printuar dhe e firmosur nga GN-ja dhe tabela e rezultateve e plotësuar me shkrim dore nga GN-ja, i bashkëngjiten njëra- tjetrës, shërbejnë si dokumentacion zyrtar dhe dorëzohen dorazi nga KZAZ-ja në KQZ, së bashku me Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ-në.
Të njëjtat rregulla, si më sipër, zbatohen edhe për tabelat e rezultateve të zgjedhjeve për kandidatët për deputet të partive politike e koalicioneve zgjedhore, të plotësuara sipas Modelit KZAZ-30.

Pas transmetimit të tabelës së rezultateve të çdo QV-je në KQZ, sipas rastit, kopje të tabelave të rezultateve **Model KZAZ 29/ Model KZAZ 30** [fotokopjohen në makinën printer/fotokopje/skaner, që ndodhet në VNV], të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen:

- çdo anëtari të GNV-së;
- anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

**! Nëse** ndonjë nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore **ka kundërshtime** në lidhje me rezultatet e pasqyruara në tabelë, ato **shënohen menjëherë** në **Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ**-së, **nga Sekretari** i saj [KZ, neni 119/2].

## 4. Nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore/ kandidatët e listave shumemërore të partive politike dhe koalicioneve zgjedhore nga KZAZ-ja

Menjëherë pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha QV-ve dhe hedhjes e transmetimit elektronik të rezultateve në KQZ, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave Tabelën Përmbledhëse
të Rezultateve për ZAZ-në për subjektet zgjedhore/ kandidatët e listave shumemërore, sipas Modelit KZAZ-31/ KZAZ 32.

.
Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të ZAZ-së, e printuar, kontrollohet nga anëtarët dhe miratohet me vendim nga KZAZ-ja, **Model KZAZ 33/ Model KZAZ 34.**

***Krahas nënshkrimit, i cili përmban emrin, mbiemrin dhe firmën, anëtari i KZAZ-së shënon sipas rastit “pro” ose “kundra” dhe vërejtje nëse ka. Mendimi i pakicës shënohet në pjesën e pasme të*** **Model KZAZ-33/ Model KZAZ -34.**

Pas miratimit, **sekretari i KZAZ**-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike, në KQZ, Tabelën Përmbledhëse  të Rezultateve të ZAZ-së dhe vendimin për miratimin e saj të firmosur nga anëtarët e KZAZ–së.

Në raste të jashtëzakonshme nëse nuk mund të printohet Tabela Përmbledhëse e Rezultateve nga baza elektronike e të dhënave, atëhere sekretari i KZAZ-së plotëson me dorë Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së, **Model KZAZ 31/ Model KZAZ 32.**

Këto tabela përmbledhëse dërguar nga KQZ me bazën materiale janë të paraprintuara me subjektet zgjedhore/ kandidatët sipas përmbajtjes së fletës së votimit.

! Pas miratimit të Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore, Sekretari i KZAZ-së merr nga GN, Procesverbalet KZAZ – 29/1 që pasqyron numrin e votave të fletëve të votimit vetëm për subjektet zgjedhore dhe ja jep Operatorit për t'i hedhur në aplikacionin përkatës në sistemin elektronik dhe përcillen elektronikisht në KQZ.

Pas këtij veprimi (pasi ka përfunduar hedhja e transmetimi elektronik i informacionit të procesverbaleve Model KZAZ 29/1 për të gjitha QV-të) Sekretari i KZAZ-së i kërkon operatorit të printojë nga baza e të dhënave Procesverbalin Përmbledhës për votat e vlefshme për partitë politike dhe koalicionet ku nuk ka votim parapëlqyes për kandidatët, Model KZAZ 31/1.

**Kujdes!** Procedurat për hedhjen dhe transmetimin elektronik të të dhënave të pasqyruara në Tabelën e Rezultateve të QV-së dhe nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve për subjektet zgjedhore janë të njëjta edhe për tabelat e rezultateve për kandidatët e listave shumemërore.

- ✓ Tabela e rezultateve për QV-në e printuar dhe e firmosur nga GN-ja dhe tabela e rezultateve e plotësuar me shkrim dore nga GN-ja, i bashkëngjiten njëra- tjetrës, shërbejnë si dokumentacion zyrtar dhe dorëzohen dorazi nga KZAZ-ja në KQZ, së bashku me tabelat e tjera për ZAZ-në, ku përfshihen TPR për subjektet, për kandidatët e listave shumemmërore të cdo subjekti si dhe procesverbalet Model KZAZ 29/1 dhe atë përmbledhës Model KZAZ 31/1.
- ✓ Tabela Përmbledhëse e Rezultateve për ZAZ-në si për subjektet zgjedhore, Model KZAZ-31, dhe për kandidatët për deputet të partive politike e koalicioneve zgjedhore, Model KZAZ-32, firmosur nga anëtarët e KZAZ-së, shërbejnë si origjinale dhe i dorëzohen KQZ-së së bashku me tabelat e rezultateve të QV-ve.
- ✓ Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

! Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, për kandidatët e printuar, kontrollohet nga anëtarët dhe miratohet me vendim Model KZAZ-34nga KZAZ-ja.

! **Në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim** për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për kandidatët/ subjektet zgjedhore,
**kryetari** ose **të paktën dy anëtarë të KZAZ**-së dërgojnë çështjen për shqyrtim në KQZ.

GN mbyll kutinë e votimit dhe plotëson procesverbalin nr. GNV 2 ku shënon numrat e kodeve të vulave të sigurisë.

**! E njëjta procedurë ndiqet për mbylljen e kutisë së votimit pas numërimit të votave për kandidatët e listave shumemërore.**

### 5. Procedura e numërimit të votave për kandidatët e listave shumemërore të partive dhe koaliconeve zgjedhore.

Fillon vetëm pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar për çdo subjekt zgjedhor, hedhjes e transmetimit të informacionit sipas procesverbalit Model KZAZ-29/1 dhe pasi është kryer kopjimi i materialit filmik të regjistrimit të fletëvë të votimit gjatë procesit të vlerësimit të tyre.

Numëruesi i parë vendos mbi tryezë kutinë me fletët e votimit të një qendre votimi, të marrë nga vendi përkatës sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, dhe e vendos atë pranë tavolinës së Grupit të Numërimit.

Merr nga sekretari i KZAZ-së kopje të Procesverbalit të vulosjes ku janë shënuar kodet e sigurisë të vulave që u mbyll kutia e votimit pas numërimit të votave të subjekteve zgjedhore.

Grupi i Numërimit të Votave kryen procedurën e verifikimit të të dhënave të këtij Procesverbali me kodet e vulave të kutisë dhe e hap atë duke këputur vulat me kodet e sigurisë.

Numëruesi i parë nxjerr në tavolinë zarfin me fletët e votimit të subjektit të parë sipas renditjes në fletën e votimit si dhe zarfin e votave të kontestuara. Zarfi me fletët e votimit ku është votuar qartësisht për subjektin zgjedhor nuk hapen,

GN vlerëson dhe numëron votat parapëlqyese për çdo kandidat të partisë politike apo koalicionit zgjedhor sipas të njëjtës procedurë të shpjeguar më sipër.

Në çdo rast GN i vendos fletët e votimit poshtë kamerës për t'i shfaqur në monitor për jo më pak se 4 sekonda.

